

# PROCESVERBAL

Në takimin Publik lidhur me themelimin e Statutit të Muzeut Etnografik

Datë: 15.09.2023

Lokacioni: Zyra e Nënkrëtarit të Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

01 Nr. Br. 631101-26737/23  
27.09.2023  
Dragash - Dragaš

## Rendi i Ditës

### 1. *Shqyrtimi i Draft Statutit të Muzeut Etnografik*

Takimin e hapi Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport, Liridona Misinaj e cila pasi ju uroj mirëseardhje te pranishmeve, i njoftoi ata me draft statutin për themelimin e Muzeut Etnografik i cili ka qene ne diskutim publik ne kohëzgjatje prej një muaji ( 15.08.2023 deri 15.09.2023) duke theksuar se me këtë statut rregullohet statusi juridik i Muzeut në Komunën e Dragashit, veprimtaria e Muzeut, organizimi, përfaqësimi, planifikimi, buxheti dhe transparenca. Gjithashtu drejtoresha sqaroi rëndësin, qëllimin e themelimit të Muzeut në komunën tonë si institucion i rëndësishëm i kulturës që ka për qëllim të shërbejë në formimin e vetëdijes mbi historikun e trashëgimisë kulturore lëvizëse të rinise dhe te qytetarëve me anë të artefakteve etnologjike, historike dhe arkeologjike . Si i tille, Muzeu është qendra me e rëndësishme në grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe shërbimin e lendeve muzeore.

Kryesuesja e takimit njoftoi se për periudhën sa ishte statuti në diskutim publik nuk ka pasur propozime e as komente nga qytetarët.

Pas prezantimit fjala u kalua tek te pranishmit.

Xhemile Elshani – Propozoi që në kuadër të Muzeut të parashihet edhe ciceroni

Ylli Qafleshi – Propozoi që vizitat në Muze të lejohen të behën pa pagesë

Drejtoresha e DKRS - Propozimet do të inkorporohen në Draft Statut dhe materiali do të dërgohet në Asamble Komunale për miratim.

Procesmbajtësi





